

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje dru zjarri e pellet për QEA”

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi**

03413000-8- **Dru zjarr**

---

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 39.996.000 (Tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH

---

**”BLERJE DRU ZJARRI E PELLETT PËR QEA”** dhe pasi i shqyrtoi ato, programoi punën për:

- a. Grumbullimin e informacionit, lidhur me përcaktimin e specifikimeve teknike të punimeve, objekt i këtij prokurimi , si dhe;
- b. Grumbullimin e informacionit, lidhur me çmimet orientuese në treg, në mënyrë për të përllogaritur vlerën limit të kontratës.

Argumentim:

- **Përllogaritja e vlerës së fondit limit :**

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjerazyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organetatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe:

a) çmimet e tregut dhe respektivisht në kompanitë me NIPT

L61307534I, K31331547R, K81407504O

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Komisioni organizoi punë për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese për mallin, objekt i këtij prokurimi;

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

1. Listat e publikuara nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
2. Institucione të tjera zyrtare të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet

Grupi u mbështet: Në hetimin e tregut vendas si dhe nga investimet e mëparshme.

*Në Përfundim, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit tregtar dhe pasi i përpunoi ato në një Tabelë Komplekse të Grumbullimit të Zërave të mallrave bazuar në një metodologji të paracaktuar, rezultoi se: Komisioni me unanimitet ; Të përcaktojë Vlerën Limit të Kontratës;*

**Për një shumë prej 39,996,000 neto pa TVSH, Për prokurimin me titull :**

“BLERJE DRU ZJARRI E PELLET PËR QEA”

- **Afatet e lëvrimit:** furnizimi i DRUVE TË ZJARRIT nga subjekti kontraktues do të bëhet nga ora 08:00 deri në orën 16:00, nga e hënë në të premte në institucionet nëpër kopshte dhe çerdhet e të gjithë Njësive Administrative të Bashkisë Durrës, nga lidhja e kontrates për një afat 150 ditore.
- **Afatet e lëvrimit:** furnizimi i PELLETIT nga subjekti kontraktues do të bëhet nga ora 08:00 deri në orën 16:00, nga e hënë në të premte në institucionet nëpër kopshte dhe çerdhet e të gjithë Njësive Administrative të Bashkisë Durrës, nga lidhja e kontrates për një afat 150 ditore.

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit .....

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39’000’000 Lek

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

---

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Kërkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe mbeshtetet ne ne nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43,b*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

*Shërben për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, me qellim për te pare aftesite financiare te operatoreve ekonomin*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore per vitin 2021, ligjin nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"neni 3.1(a,b,c). Dokumentat e kerkuara me siper, do te paraqiten nga operatori ekonomik fitues para dhenies se kontrates ose nese kerkohen sqarime nga A.K.*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15'900'000 lekë

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Referuar fondit limit sipas nenin 40, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

---

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë :(shënim- përcaktoni, **nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).**

- Leje mjedisi tipi B, “veprimtaritë e lëndës së drurit” 7.10

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. çertifikata e rregjistrimit të QKR duhet të ketë lidhje me objektin e prokurimit. Kategoria e liçensimit Tipit B “*Veprimtaritë e lëndës së Drurit*” 7.10 .Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, çertifikatë ISO 9001 Manaxhimit të Cilësisë,

për të dëshmuar se mbajtesi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij, si dhe ligjit 52/2020 "Per disa ndryshime ne ligjin nr.10448, date 14.07.201 "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- a. ....
- b. ....
- c. ....

.....

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Drejtues mjete per kategorite e mjeteve te kerkuara 2(dy)
- b. Punonjes me deshmi kualifikimi për punues druri të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik(ose ekuivalenti i tij/saj) 2(dy)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj  
Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të specifikimeve/preventivit, numri i punonjësve është përcaktuar për efekt të volumit të punës dhe të shpërndarjes gjeografike në të gjithë territorin e Durrësit,

.....

*(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar.kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).*

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 4 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të zbërthimit të specifikimeve/preventivit dhe të grafikut të shpërndarjes, për arsye se furnizimi është ditor edhe në orë të përcaktuar për të gjithë institucionet e varësisë sipas grafikut si dhe shtrirjes së madhe gjeografike të këtyre institucioneve, sipas punonjesve të mesipërm

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton copë 1
- Automjete (ATP) me masë maksimale të autorizuar deri në 3.5 ton copë 1

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*Mjetet e mësipërme kërkohen, duke u bazuar në planim e shpërndarjes për arsye se furnizimi është ditor edhe në orë të përcaktuar për të gjithë institucionet e varësisë sipas grafikut si dhe shtrirjes së madhe gjeografike të këtyre institucioneve.*

*(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).*

## 2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Certifikat: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i

akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Nenit 79, pika 1 të ligjit nr 162 dt 23.12.2020 për “Prokurimin publik” si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 44 ku cilësohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

#### **Kërkesat e cilësisë, ISO 9001**

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e investimit/kontratës. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

**2.4.2** Per arsye se furnizimi mund te jete ditor dhe ne ore te percaktuar per te gjithë institucionet e varesise sipas grafikut si dhe shtrirjes se madhe gjeografike te ketyre institucioneve, kerkohet qe ofertuesi te deklaroje me ane te nje deklarate qe ka gjendje apo mund te siguroje brenda periudhes se kerkuar sasine e kerkuar te mallit, ose kontrate furnizimi te vlefshme deri ne perfundimin e kontrates. Per kete pike Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje vendodhjen e mallit te shoqeruar me Ambjente magazinimi dhe deklarimin e gjendjes te mallit qe kerkohet, ne menyre qe te verifikohet nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Argumentimi:**

Sipas “Specifikimet teknike” (Drutë e zjarrit; Të mos jenë të kalbura dhe të jenë të thata) me qëllim që drutë e zjarrit të jenë në magazinë të mbrojtur nga lagështira dhe të vijnë të thata në institucion, lehtësisht për t’u verifikuar nga institucioni. Lagështira në brendësi të druve të zjarrit nxjerr tym gjatë djegies dhe si pasojë sjell probleme në shëndetin e fëmijëve.



### 2.4.3 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” : “..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifitime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomkisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe neni 36, të LPP, si dhe neni 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

Emri Bashkia Durrës  
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës  
Tel/Faks 052 22 23 10  
E-mail [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al)  
Ueb-faqe [www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al)

**2. Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e Hapur, Mall

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-61664-03-07-2023

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** “Blerje dru zjarri e pellet për QEA”

**5. Fondi limit:** 39.996.000 (Tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

**6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 150 ditë

**7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** 23.03.2023 Ora: 10:00

**Njësia e Prokurimit**